



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 5 i Regj. Themeltar  
Nr. 5 i Vendimit**

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Ilir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Albana BOKSI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Klodian KURUSHI</b>	<b>Anëtar</b>

sot, në datë 27.07.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale me nr.5-2021 Regj.Them, që i përket:

**KËRKUES:** Bardhyl Ibra

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit Nr.266, datë 13.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi me vendimin Nr.47, datë 16.02.2010, të Gjykatës së Apelit Durrës.

**BAZA LIGJORE:** Neni 417 i Kodit të Procedurës Penale.

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Me vendimin nr. 266, datë 13.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 246/2 i Kodit Penal (KP) dhe është dënuar me një vit burgim, dënim i pezulluar në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 47, datë 16.2.2010, ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të paraqitjes tej afatit ligjor. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal.

2. Kërkuesi Badhyl Ibra i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit Nr.266, datë 13.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi me vendimin Nr.47, datë 16.02.2010, të Gjykatës së Apelit Durrës", me argumentin se pezullimi i ekzekutimit duhet të bëhet derisa të shqyrtohet rekursi

i tij ndaj vendimit penal për të cilin është deklaruar fajtor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

3. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**, me vendimin nr. 513, datë 24.05.2010, ka vendosur të “Shpallë moskompetencën për gjykimin e çështjes administrative-penale nr. 53, akti, që i përket kërkuesit Bardhyl Ibra, me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 266, datë 13.06.2008, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Lartë”.

4. Kërkuesi ka ushtruar rekurs kundër këtij vendimi dhe **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. 938, datë 02.07.2010, në Dhomë Këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi.

5. **Gjykata Kushtetuese**, me vendimin nr.51, datë 30.11.2011, ka vendosur:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2010-938, datë 02.07.2010, të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

4.1 Në marrjen e vendimit Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar ndërmjet të tjerash se, neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon, *inter alia*, se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimi, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t’iu drejtuar asaj gjykate. Qëllimi i këtij neni është të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet, për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. (*shih vendimin nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

Për të garantuar të drejtën e një individi për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disjunojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP-së) dhe paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 38, datë 30.12.2010; vendimin nr. 5, datë 02.03.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin konkret, Gjykata vëren se, kërkuesi ka depozituar pranë sekretarisë së Gjykatës së Lartë një rekurs të panënshkruar nga mbrojtësi i tij. Për pasojë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se në kushtet e mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit, nuk janë plotësuar kërkesat formale të nenit 435/2 të KPP-së.

Gjykata çmon se në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë të evidentuar më lart, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pasur përgjegjësinë, që, para se të vendoste mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, të verifikonte nëse sekretaria gjyqësore kishte zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.09.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që të jetë përmbushur ky detyrim.

6. Në vijueshmëri, kërkuesi Bardhyl Ibra në datën 09.06.2017 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pas dhënies së vendimit nr.51, datë 30.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata duke vlerësuar se kërkuesit Bardhyl Ibra i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr.87/17 ka vendosur, konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

7. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. 00-2021-244, datë 02.04.2021, në Dhomë Këshillimi, ka vendosur "Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Bardhyl Ibra kundër vendimit me nr.513, datë 24.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan." Për shkak se edhe pas njoftimit të kryer nga administrata e Gjykatës së Lartë rekursuesi Bardhyl Ibra nuk ka plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, si një detyrim që buron nga neni 415/2 i KPP dhe vendimi unifikues nr.5, datë 15.09.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

8. Në vijimësi në Gjykatën e Lartë është regjistruar kërkesa e kërkuesit Bardhyl Ibra me objekt "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit Nr.266, datë 13.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi me vendimin Nr.47, datë 16.02.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës", si rrjedhojë e zbatimit të vendimit nr. 513, datë 24.05.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

## II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

9- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) evidenton se kërkuesi ka paraqitur kërkesë për pezullim ekzekutimi pasi ka bërë recurs ndaj vendimit vendimin Nr.47, datë 16.02.2010, të Gjykatës së Apelit Durrës, në mbështetje të neni 417 i KPP ku përcaktohet se "*... në rastet e rekursit, vendimi mund të pezullohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vetëm në rastet e parashikuara nga pika 1 e nenit 476 të këtij Kodi ....*"

10- Referuar nenit 476/1 të KPP i dënuari mund të kërkojë pezullimin e ekzekutimit kur i dënuari vuan nga një sëmundje që pengon ekzekutimin e vendimit, kur e dënuara është shtatzënë ose me fëmijë nën një vjeç, kur vuajtja e menjëhershme e dënimit mund të sjellë pasoja të rënda për të dënuarin ose familjen e tij dhe në çdo rast tjetër që çmohet nga gjykata si i veçantë.

11- Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12- Rezulton se **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2016-1470, datë 22.09.2016**, ka vendosur: "*Mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari Bardhyl Ibra, kundër vendimit nr.186, datë 04.03.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës.*". Më parë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.137, datë 17.04.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr.47, datë 16.02.2010, të Gjykatës së Apelit Durrës (vendim objekt kërkesë për pezullim ekzekutimi). Ndërkohë rezulton se, pasi aktet janë kthyer për rigjykim, me vendimin nr.186, datë 04.03.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur: "*Lënia në fuqi të vendimit nr.266, datë 13.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*".

Nën dritën e këtyre rrethanave Kolegji, vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.266, datë 13.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ngelet pa objekt, pasi vendimi objekt kërkesë është ekzekutuar.

13- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, referuar objektit të gjykimit dhe të rekursit, vlerëson se për shqyrtimin e saj duhet t'i referohet dispozitave procedurale penale në Kodin e Procedurës Penale (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) si:

- Neni 433, "Mospranimi i rekursit"

*"1. Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1, të nenit 432, të këtij Kodi.*

*2. Mospranimi i rekursit vendoset nga një trup gjykues me tre gjyqtarë në dhomën e këshillimit."*

Neni 420, Mospranimi i ankimit

*"1. Me përjashtim të rasteve kur konstatohet në seancë, ankimi nuk pranohet në dhomë këshillimi:.....*

*d) kur ankimi nuk ka më objekt...*

*2. Mospranimi mund të deklarohet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit."*

14- Bazuar në nenet 433 e 420 të Kodit të Procedurës Penale të sipërcituara, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se duhet të vendoset mospranimi i rekursit për çështjen penale të regjistruar pranë kësaj gjykate me nr. 5 Them, datë 10.06.2021, të paraqitur nga Bardhyl Ibra, për shkak mbetjes së kërkesës pa objekt.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 420, pika 1, shkronja "d" dhe 433 të Kodit të Procedurës Penale,

## **V E N D O S I:**

Mospranimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesit Bardhyl Ibra, kundër vendimit Nr.266, datë 13.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**Tiranë, më 27.07.2021**

**A N Ë T A R**

**A N Ë T A R E**

**K R Y E S U E S**

**Klodian KURUSHI**

**Albana BOKSI**

**Ilir PANDA**